



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 182, datë 13.12.2011

**PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “BANKA SOCIETE GENERAL - ALBANIA”
SH.A PËR TË VEPRUAR SI DEPOZITAR I FONDIT TË PENSIONIT
VULLNETAR**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/c, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 47, të Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, të nenit 72 të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, dhe Rregullores nr. 21, datë 26.03.2009 “Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Licencimin e shoqërisë “Banka Societe General - Albania” sh.a për të vepruar si Depozitar i fondit të pensionit vullnetar.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Elisabeta GJONI**